

VENDIM
Nr. 56, datë 27.12.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME
SHKODËR SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM-ja nr.958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 27.12.2023, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin për herë të parë të shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a.’”,

KONSTATON SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a., me shkresën nr. 1452 prot., datë 10.11.2023 dhe me shkresën nr. 2302 prot., datë 12.12.2023, plotësim dokumentacioni mbi aplikimin për licencim, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Shkodër sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” (VKM-ja nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. (NUIS M37819701O) është themeluar më datë 5.4.2023, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51%, dhe bashkitë Shkodër me 36.33%, Vau-Dejës me 3.23%, Malësi e Madhe me 6.39%, Pukë me 2.19% dhe Fushë-Arrëz me 0.86%;

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Lazër Pemaj, është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në vitin 1989 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

c) Drejtuesi teknik i shoqërisë, znj. Blerina Arrtunda, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Mjedis, profili trajtim uji, në vitin 2017 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

d) Shoqëria Rajonale UK Shkodër sh.a. deklaron se ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 172 838 banorë të bashkive UK Shkodër, UK Vau-Dejës, UK Malësi e Madhe, UK Pukë, UK Fushë-Arrëz;

e) Shoqëria Rajonale UK Shkodër sh.a. deklaron se ofron shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura për ITUN Velipojë dhe Shirokë me një kapacitet për rreth 50,000 PE, për 40 000 banorë të qytetit të Shkodrës.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë Rajonale UK Shkodër sh.a., të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësitë tekniko-profesionale, aftësitë financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Shkodër sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. me (NUIS M37819701O), në kategoritë:

- a) Kategorija A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) Kategorija C - Për largimin e ujërave të ndotura,
- c) Kategorija D - Për përpunimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues ligjor: Mark Molla;
- b) Drejtues teknik: Lazër Pemaj;
- c) Drejtues teknik: Blerina Arrtunda.

3. Zona e shërbimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. janë bashkitë Shkodër, Vau-Dejës, Malësi e Madhe, Pukë, Fushë-Arrëz.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

7. Vendimi i KKRR-së nr.160, datë 30.12.2020, “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR-së nr. 271, datë 28.12.2021, “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a.”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani